



Arsyet pozitive për vaksinimin kundër Covid-19

Përse të vaksinoheni kundër Covid-19? Sepse ka shumë arsye pozitive. Vaksinimi kundër Covid-19 është shumë i rëndësishëm për të luftuar pandeminë e Covid-19. Vaksinimi plotëson masat e tjera mbrojtëse, si për shembull rregullat e higjienës dhe të sjelljes. Vaksinimi mbron kundër sëmundjeve dhe në veçanti kundër kalimit të sëmundjes në gjendje të rëndë. Sa më shumë njerëz të vaksinohen në Zvicër, aq më pak do të nevojiten masat e tjera mbrojtëse.

Mbroni veten nga një sëmundje në gjendje të rëndë.

Infektimi me Covid-19 mund të jetë shumë i rrezikshëm për personat e moshuar dhe ata me sëmundje kronike. Në rast infektimi me koronavirus, të rinjtë dhe personat e shëndetshëm kanë simptoma të lehta ose nuk kanë fare simptoma. Por nuk përjashtohet mundësia që edhe ata mund ta kalojnë këtë sëmundje në gjendje të rëndë. Vaksinimi ju mbron kundër sëmundjes me Covid-19, në veçanti ndaj formave të rënda të tij. Personat e vaksinuar shkojnë shumë më rrallë në spital sesa personat e pavaksinuar për shkak të Covid-19. Vaksinat që përdoren në Zvicër janë të sigurta ofrojnë një mbrojtje shumë të mirë nga një sëmundje me Covid-19. Në mënyrë që vakcina të miratohet dhe të rekomandohet për përdorim në Zvicër, duhet që përfitimet nga përdorimi të jenë më të mëdha se rreziqet. Përvojat e deritanishme me këto vakcina janë një tregues i qartë i këtij fakti.

Shmangia e pasojave të COVID-19

Pas infektimit mund të shfaqen probleme shëndetësore që vazhdojnë për kohë të gjatë (Covid afatgjatë) – si për shembull vështirësia në frymëmarrje në punët me sforcim ose ndjesia e lodhjes. Këto mund të ndodhin edhe te personat e rinj në moshë dhe të shëndetshëm. Kur vaksinoheni, ju zvogëloni rrezikun për t'u sëmurur dhe të pasojave të mundshme afatgjata të sëmundjes. Në dallim nga kjo, efektet anësore të rënda pas vaksinimit me vaksinat e përdorura në Zvicër kundër Covid-19 janë shfaqur shumë rrallë. Nuk priten efekte të vona nga vaksinat.

Fitimi i imunitetit në mënyrë të sigurt

Fitimi i imunitetit nëpërmjet infektimit dhe sëmundjes është diçka që nuk këshillohet. Sepse kjo mund të rezultojë edhe në sëmundje të gjendje të rëndë, si dhe në pasoja afatgjata. Me vaksinën kundër Covid-19 ju mund të siguronit një mbrojtje më të mirë dhe afatgjatë, pa u rrezikuar nga infektimi me koronavirus. Sipas gjendjes aktuale të kërkimeve shkencore, vakcina mbron nga sëmundja për të paktën dymbëdhjetë muaj. Aktualisht nuk ka asnjë provë që mbrojtja ndaj sëmundjes së rëndë zvogëlohet ndjeshëm pas kësaj kohe në popullatën e gjerë. Edhe personat që kanë rezultuar pozitivë pas testit të koronavirusit, duhet që të marrin një dozë të vaksinës të paktën brenda tre muajve pas infektimit. Në këtë mënyrë ata mbrohen më mirë dhe për kohë më të gjatë nga një infektim i ri.

Mbështetja e personelit shëndetësor

Për shkak të pandemisë, personeli shëndetësor dhe sistemi shëndetësor përballen me një ngarkesë të madhe herë pas here. Me mbrojtjen me anë të vaksinës, juve nuk ju nevojiten asnjë trajtim për sëmundjen me Covid-19 në gjendje të rëndë. Në këtë mënyrë ju ndihmoni në lehtësimin e ngarkesës së sistemit shëndetësor. Kështu do të jenë të mundura trajtimet e sëmundjeve të tjera dhe rastet e urgjencave.

Mbrojtja e njerëzve në ambientin tuaj

Pas vaksinimit, rreziku që ju të infektoheni dhe të infektoni edhe të tjerët është dukshëm më i vogël. Edhe kur vaksinimi nuk e ndalon plotësisht transmetimin, ju mund të mbroni personat që janë veçanërisht të rrezikuar. Për shembull, personat me sistem imunitar të dobët, tek të cilët vakcina nuk ka efekt shumë të mirë. Dhe vaksinimi juaj mbron edhe personat që për arsye mjekësore nuk mund të vaksinohen, si për shembull fëmijët, për të cilët nuk disponohet ende asnjë vaksinë. Sa më shumë persona të vaksinohen, aq më pak do të sëmuren me Covid-19 dhe aq më pak do të infektojnë personat e tjerë.

Forcimi i shëndetit mendor

Përhapja e koronavirusit në këtë pandemi ka pakësuar kontaktet me njerëzit tanë të afërm. Kjo mund të ndikojë në mirëqenien e njerëzve dhe të favorizojë ose të përforcojë sëmundjet mendore. Mbrojtja nëpërmjet vaksinimit kundër Covid-19 mund të kontribuojë në zvogëlimin e frikës dhe të na ndihmojë t'i jetojmë sërish kontaktet më të relaksuar. Vaksinimi është edhe një akt solidariteti me të afërmit tanë.

Lufta kundër efekteve të pandemisë

Kur të sëmuren pak persona me Covid-19, atëherë do të jetë sërish e mundur një rutinë ditore normale. Vaksinimi është mjeti më efikas që së bashku me rregullat e higjienës dhe të sjelljes t'i japim fund kësaj pandemie dhe t'i rikthehemi kënaqësisë së shijimit të jetës dhe normalitetit. Sa më shumë persona të vaksinohen në Zvicër, aq më shpejt do të mund të hiqen masat kufizuese. Me vaksinimin ju jepni një kontribut të rëndësishëm për shëndetin tuaj personal dhe shëndetin e të tjerëve – në Zvicër, në Evropë dhe në botë.

